



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

Qendra Kombëtare e Kinematografisë

Nr. 26 Prot.

Tiranë, më 14 / 01 / 2026



QENDRA
KOMBËTARE E
KINEMATOGRAFISË

Universiteti i Arteve

Nr. 70 Prot.

Tiranë, më 14 / 01 / 2026



UNIVERSITETI
ARTEVE

MARRËVESHJE BASHKËPUNIMI
NDËRMJET
QENDRËS KOMBËTARE TË KINEMATOGRAFISË
DHE
UNIVERSITETIT TË ARTEVE



PREAMBULA

Kjo Marrëveshje Bashkëpunimi ("Marrëveshja") lidhet ndërmjet:

1. Qendrës Kombëtare të Kinematografisë ("QKK"), me NIPT K51726026A me seli në rrugën "Aleksandër Moisiu", nr.77, Tiranë, përfaqësuar nga Kryetari, Z. Jonid JORGJI

dhe

2. Universitetit të Arteve ("UA"), me NIPT K51713024L, me seli në adresën: Sheshi "Nënë Tereza", Bulevardi "Dëshmorët e Kombit", Tiranë, përfaqësuar nga Prof. Dr. Erald Bakalli, në cilësinë e Rektorit, institucion i arsimit të lartë publik, i krijuar me Vendim të Këshillit të Ministrave nr. 234 datë 23.03.2011 dhe funksionues në bazë të Ligjit nr. 80/2015 "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë", të ndryshuar;

Së bashku të referuara si "Palët" dhe veçmas si "Pala".

Me synim forcimin e bashkëpunimit ndërinstitucional, përmirësimin e cilësisë së formimit të rinisë krijuese dhe mbështetjen konkrete të studentëve të fushës së kinematografisë, Palët bien dakord si më poshtë:

NENI 1 OBJEKTI I MARRËVESHJES

1. Objekti i kësaj Marrëveshjeje është krijimi i një mekanizmi të qëndrueshëm institucional për mbështetjen financiare dhe profesionale të produksioneve filmike studentore përmes:

- a) Financimit të projekteve filmike studentore;
- b) Mentorimit profesional nga producentë të emëruar nga QKK;
- c) Krijimit të një procedure transparente, meritokratike dhe konkurruese për përzgjedhjen e projekteve fituese;
- d) Angazhimit praktik të studentëve në degët e arteve pamore, aktrim, dhe regji gjatë xhirimit dhe produksionit të prodhimeve të financuara nga QKK;
- e) Bashkëpunimit të ndërsjellë në kuadër të projekteve apo iniciativave të mundshme që lidhen me ngritjen e kapaciteteve, mobilitetin dhe shkëmbimin e eksperiencave.
- f) QKK do të shërbejë si urëlidhëse për koordinimin e praktikës në terren të studentëve të UA-së. Procedura e nominimit dhe përzgjedhjes së studentëve që do të zhvillojnë praktikën përcaktohet me marrëveshje të veçantë ndërmjet palëve.

1.2. Mbështetja në pikat a), b) dhe c) të Nenit 1 i drejtohet studentëve të vitit të 3-të Bachelor të programeve të studimit "Aktrim", "Regji", "Regji Filmi dhe Televizioni", "Skenografi-Kostumografi", "Koreografi", "Pikturë Kavaleti", "Pikturë Monumentale", "Skulpturë", "Skulpturë Qeramikë", "Pikturë Grafikë", "Pikturë Tekstil dhe Modë", "Pikturë Multimedia", "Fotografi" dhe studentëve të ciklit të 2-të Master të këtyre programeve të studimit, pranë UA-së, për të cilët realizimi i projektit filmik përbën kërkesë të detyrueshme të diplomimit.

1.3. Financimi për sa më sipër jepet në formën e një grant produksioni që administrohet sipas procedurave të QKK-së për mbështetje produksionesh filmike.



NENI 2 BAZA LIGJORE

Kjo Marrëveshje mbështetet në dispozitat përkatëse të:

1. Ligjit nr. 8096, datë 21.03.1996 "Për kinematografinë", të ndryshuar;
2. Ligjit nr. 80/2015 "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë", të ndryshuar;
3. Vendimit nr. 145, datë 10.3.2021 "Për dhënien e statusit të veçantë Universitetit të Arteve si institucioni i vetëm publik i arsimit të lartë në fushën e arteve në Republikën e Shqipërisë";
4. Ligjit nr. 35/2016 "Për të drejtat e autorit dhe të drejtat e ndërlidhura me to";
5. Akteve nënligjore të QKK-së për mbështetjen e produksioneve filmike.

NENI 3 FONDI I MBËSHTETJES PËR PRODUKSIONET STUDENTORE

3.1. QKK krijon një fond të dedikuar vjetor për mbështetjen financiare të produksioneve filmike studentore, i cili buxhetohet dhe administrohet sipas procedurave të brendshme institucionale dhe legjislacionit për financat publike.

3.2. QKK angazhohet të mbështesë financiarisht projekte filmike studentore gjatë kohëzgjatjes së kësaj Marrëveshjeje, në përputhje me disponibilitetin buxhetor vjetor dhe cilësinë e projekteve të paraqitura.

3.3. Vlera e mbështetjes për çdo projekt përcaktohet në momentin e thirrjes vjetore dhe mund të përshtatet sipas nevojave të projektit dhe prioriteteve të QKK-së.

3.4. Financimi formalizohet përmes një Kontrate Produksioni të veçantë që lidhet ndërmjet QKK-së dhe studentit fitues (ose entitetit të autorizuar nga studentit), e cila përcakton afatet, detyrueshmëritë, grafikun e pagesave nga QKK dhe kushtet e realizimit.

3.5. Shpërndarja e fondeve bëhet në faza (para-prodhim, prodhim, post-prodhim) sipas specifikave të kontratës individuale dhe në përputhje me standardet e QKK-së.

3.6. Në rast se asnjë projekt nuk plotëson standardet cilësore të kërkuara, QKK rezervon të drejtën të mos dhurojë mbështetje financiare për atë vit akademik.

NENI 4 PROCESI I PËRZGJEDHJES SË PROJEKTEVE FITUESE

4.1. KALENDARI DHE PROCEDURA

- a) QKK njofton zyrtarisht UA-në për hapjen e thirrjes për projekte dhe kushtet e aplikimit;
- b) UA publikon thirrjen dhe afatet e dorëzimit në platformën e saj akademike (afati minimal për aplikim është 30 ditë kalendarike);
- c) Studentët paraqesin projektet e tyre nëpërmjet UA-së, sipas formatit dhe dokumentacionit të kërkuar nga QKK;
- d) Vlerësimi i projekteve kryhet nga Komisioni Vlerësues brenda [30] ditëve nga mbyllja e thirrjes.



4.2. KOMISIONI VLERËSUES

Projektet fituese përzgjidhen nga një Komision i përbërë nga:

1. Dy (2) producentë profesionistë me përvojë të dëshmuar në fushën e kinematografisë, të emëruar nga QKK;
2. Një (1) pedagog i programit "Regji Filmi dhe Televizioni" i emëruar nga UA (që nuk është pedagog udhëheqës i projekteve kandidate);
3. Një (1) përfaqësues i QKK-së me rol koordinues dhe pa të drejtë vote.

Vendimi i Komisionit Vlerësues për projektet fituese i paraqitet për miratim Komisionit të Miratimit të Projekteve (KMP) pranë QKK-së, i cili autorizon disbursimin e fondeve në përputhje me procedurat e brendshme të QKK-së.

4.3. DOKUMENTACIONI I KËRKUAR

Dokumentacioni dhe kriteret specifike që duhet të paraqesin studentët për aplikim përcaktohen me udhëzim të brendshëm të QKK-së për çdo thirrje vjetore.

4.4. KRITERET E VLERËSIMIT

Vlerësimi i projekteve bazohet në kriteret e mëposhtme:

1. Cilësia artistike dhe origjinaliteti i skenarit;
2. Koncepti regjisorial dhe vizioni krijues;
3. Realizueshmëria teknike dhe buxhetore e projektit;
4. Potenciali i studentit dhe kontributi i projektit në zhvillimin e tij profesional.

4.5. VENDIMMARRJA

1. Vendimi merret me shumicë të thjeshtë të votave të anëtarëve me të drejtë vote;
2. Vendimi protokollohet me proces-verbal të nënshkruar nga të gjithë anëtarët e Komisionit;
3. Rezultati final i njoftohet UA-së zyrtarisht palëve brenda 5 ditëve pune nga marrja e vendimit.

4.6. TRANSPARENCA DHE OBJEKTIVITETI

1. Procesi i vlerësimit është i hapur dhe transparent për të gjithë studentët pjesëmarrës;
2. Çdo aplikant ka të drejtë të marrë përshtypje të shkruar mbi vlerësimin e projektit të tij;
3. Vendimi final i Komisionit është i pakthyeshëm dhe i paankimueshëm;
4. Anëtarët e Komisionit janë të detyruar të respektojnë konfliktin e interesit dhe të deklarojnë çdo lidhje personale ose profesionale me aplikantët.

NENI 5 PËRGJEGJËSITË E PALËVE

5.1. QKK ANGAZH OHET TË:

1. Emërojë producentët profesionistë që marrin pjesë në Komisionin Vlerësues;
2. Organizojë procesin e vlerësimit në bashkëpunim me UA-në;
3. Lidhë kontratën e financimit me projektin/projektet fituese;
4. Paguajë fondet sipas grafikut të miratuar në kontratë dhe në përputhje me ecunë projektit;
5. Mbikëqyrë realizimin artistik, financiar dhe procedural të projektit;



6. Ofrojë mentorimin profesional gjatë fazave të prodhimit (sipas disponibilitetit);
7. Përfshijë filmin/filmat e realizuar në programet institucionale të QKK-së (shfaqje publike, festivale, arkiv kombëtar);
8. Garantojë që procesi respekton parimet e transparencës dhe meritokracisë.

5.2. UA ANGAZHOHET TË:

1. Publikojë thirrjen për projekte në faqen zyrtare të saj dhe të informojë studentët e programeve të studimit të cilësuar sipas kësaj marrëveshjeje;
2. Mbledhë dhe dorëzojë pranë QKK-së aplikimet e studentëve brenda afatit të përcaktuar;
3. Verifikojë që studentët aplikues plotësojnë kriteret akademike dhe janë në përputhje me kërkesat e diplomimit;
4. Emërojë pedagog udhëheqës për çdo projekt kandidat;
5. Sigurojë mbikëqyrje dhe mentorim akademik gjatë realizimit të projektit/projekteve fituese;
6. Lehtësojë koordinimin logjistik dhe akademik të nevojshëm për realizimin e projekteve;
7. Garantojë, brenda mundësive, që studentët fitues respektojnë afatet dhe detyrimet e kontratës.

5.3. STUDENTI FITUES (PRODUCENTI I PROJEKTIT) ANGAZHOHET TË:

1. Përdorë fondet ekskluzivisht për realizimin e projektit të miratuar;
2. Respektojë standardet profesionale, afatet dhe specifikimet teknike;
3. Raportojë tek QKK dhe pedagogë udhëheqës çdo ndryshim të rëndësishëm në projekt;
4. Dorëzojë produktin final (filmin e montuar) sipas formatit dhe specifikave të kërkuara;
5. Bashkëpunojë me QKK-në për promovimin dhe shfaqjen publike të filmit;
6. Kthejë çdo fond të papërdorur ose të shpenzuar në mënyrë jo të justifikueshme, sipas auditimit financiar.

5.4. PËRGJEGJËSIA PËR REALIZIMIN E PROJEKTIT

Duke qenë se projekti filmi përbën kërkesë të diplomimit, studenti ka përgjegjësi të plotë për përfundimin e tij. Në rast të mosrealizimit ose braktisjes së projektit për arsye të pajustificueshme, QKK ka të drejtë të kërkojë kthimin e fondeve të shpenzuara dhe të pezullojë bashkëpunimin me studentin për projekte të ardhshme.

NENI 6


PRONËSIA INTELEKTUALE DHE TË DREJTAT E AUTORIT

6.1. Të gjitha të drejtat e autorit dhe pronësisë intelektuale mbi projektet filmike studentore i takojnë ekskluzivisht autorëve/studentëve dhe bashkëautorëve përkatës, në përputhje me Ligjin nr. 35/2016 "Për të drejtat e autorit dhe të drejtat e ndërlidhura me to".

6.2. QKK dhe UA nuk fitojnë të drejta pronësie mbi veprat e realizuara, por mund t'i përdorin ato për qëllime institucionale jo-komerciale, duke respektuar të drejtat morale të autorit.

6.3. QKK dhe UA kanë të drejtë të përdorin materialet promovuese (postera, fotogram, fragmente, trailers) për qëllime:

1. Promovimi institucional dhe edukativ;
2. Raportimi publik dhe mediatik;
3. Prezantimi në konferenca, panaire dhe evenimente kulturore;



4. Publikime në faqet zyrtare dhe rrjetet sociale institucionale; pa kërkuar pëlqim paraprak, por duke respektuar të drejtat morale të autorit dhe duke e kredituar atë siç duhet.

6.4. Një kopje cilësore e filmit të realizuar arkivohet në Arkivin Kombëtar të Filmit (QKK) si pjesë e patrimonit kulturor kombëtar, për qëllime historike, kërkimore dhe edukative, pa prekur të drejtat komerciale të autorit.

6.5. Çdo përdorim komercial (shitje, licencim, shpërndarje tregtare) i filmit kërkon marrëveshje të veçantë ndërmjet autorit dhe palëve të interesuara, dhe nuk rregullohet nga kjo Marrëveshje.

NENI 7 MONITORIMI DHE RAPORTIMI

7.1. Palët zhvillojnë një mbledhje vlerësuese të paktën një herë në vit për të diskutuar:

- a) Zbatimin e Marrëveshjes;
- b) Cilësinë artistike dhe teknike të projekteve të realizuara;
- c) Sfidat e hasura gjatë procesit;
- d) Rekomandimet për përmirësimin e bashkëpunimit.

7.2. UA paraqet një raport vjetor institucional që përfshin:

- a) Numrin e studentëve aplikues dhe përshkrimin e projekteve kandidate;
- b) Vlerësimin e procesit mësimor dhe kontributin e projekteve në formimin e studentëve;
- c) Rekomandimet për vitin akademik të ardhshëm.

7.3. QKK paraqet një raport financiar dhe artistik që përfshin:

- a) Shpërndarjen e fondeve dhe ecurinë financiare të projekteve;
- b) Vlerësimin artistik të rezultateve;
- c) Shfaqjet publike dhe pjesëmarrjen në festivale;
- d) Rekomandimet për përmirësimin e kritereve dhe procesit.

NENI 8 KONFIDENCIALITETI

8.1. Palët angazhohen të mbajnë konfidenciale informacionet e mëposhtme:

- a) Të dhënat personale të studentëve aplikues, në përputhje me ligjin nr. 124/2024;
- b) Përmbajtjen e projekteve të parrealizuara (skenarët, konceptet);
- c) Qëndrimet e brendshme të Komisionit Vlerësues;
- d) Çdo informacion që palët bien dakord ta trajtojnë si konfidencial.

8.2. Nuk konsiderohen informacion konfidencial:

- a) Vendimi përfundimtar i Komisionit dhe projekti/projektet fituese;
- b) Informacioni i publikuar zyrtarisht nga Palët;
- c) Materialet promovuese të filmave të realizuar.



8.3. Këto dispozita nuk zbatohen në rastet kur ligji kërkon zbulimin e informacionit ose kur kërkohet nga autoritetet kompetente.

NENI 9

KOHËZGJATJA DHE NDËRPRERJA E MARRËVESHJES

9.1. Kjo Marrëveshje hyn në fuqi në datën e nënshkrimit nga të dyja Palët dhe ka kohëzgjatje tre (3) vjet.

9.2. Marrëveshja rinovohet automatikisht për periudha të tjera tre (3) vjeçare, përveç nëse njëra Palë deklaron me shkrim qëllimin për mosrinovim jo më vonë se 90 ditë kalendarike para skadimit.

9.3. Secila Palë mund ta ndërpresë këtë Marrëveshje me njoftim me shkrim të paktën 90 ditë kalendarike paraprakisht, duke dhënë arsyet e vendimit.

9.4. Ndërprerja e Marrëveshjes nuk prek detyrimet dhe të drejtat për projektet që janë në proces realizimi në momentin e ndërprerjes. Këto projekte duhet të përfundojnë sipas kontratave ekzistuese dhe kushteve të miratuara.

9.5. Në rast të ndërprerjes, Palët angazhohen të bashkëpunojnë në mirëbesim për një tranzicion të qetë që nuk dëmton interesat e studentëve dhe projektet në zhvillim.

NENI 10

ZGJIDHJA E MOSMARRËVESHJEVE

10.1. Çdo mosmarrëveshje që rrjedh nga interpretimi, zbatimi ose ndërprerja e kësaj Marrëveshjeje zgjidhet fillimisht përmes dialogut të drejtpërdrejtë dhe negociatave ndërmjet përfaqësuesve të Palëve.

10.2. Nëse dialogu nuk sjell një zgjidhje të pranueshme brenda 30 ditëve kalendarike, çështja mund t'i drejtohet Ministrisë së Kulturës, Turizmit dhe Sportit për ndërmjetësim institucional.

10.3. Si zgjidhje e fundit, mosmarrëveshjet e pazgjidhura sipas pikave të mësipërme do të zgjidhen në përputhje me legjislacionin shqiptar nga gjykatat kompetente të Republikës së Shqipërisë.

NENI 11

NDRYSHIME DHE AMENDAMENTE

11.1. Çdo ndryshim ose amendament i kësaj Marrëveshjeje bëhet vetëm me marrëveshje të shkruar ndërmjet Palëve dhe hyn në fuqi pas nënshkrimit nga të dyja palët.

11.2. Asnjë deklaratë verbale ose korrespondencë joformale nuk mund të modifikojë kushtet e kësaj Marrëveshjeje.

NENI 12

DISPOZITA PËRFUNDIMTARE

12.1. Kjo Marrëveshje hartohet në dy (2) kopje origjinale me fuqi të njëjtë ligjore, nga një kopje për secilën Palë.



12.2. Palët deklarojnë se kanë kompetencat dhe autorizimet e nevojshme për të lidhur këtë Marrëveshje në përfaqësim të institucioneve përkatëse.

12.3. Kjo Marrëveshje interpretohet dhe zbatohet në përputhje me legjislacionin e Republikës së Shqipërisë.

12.4. Çdo njoftim ose komunikim zyrtar ndërmjet Palëve duhet të bëhet me shkrim dhe të dërgohet në adresat e mëposhtme:

a) **Për Qendrën Kombëtare Kinematografike:**

Person Kontakti: Rina Plaku
Adresa: "Aleksandër Moisiu", nr.77, Tiranë
E-mail: Rina.Plaku@qkk.gov.al

b) **Për Universitetin e Arteve:**

Person Kontakti: Dr. Elis Mataj
Adresa: Sheshi "Nënë Tereza", Bulevardi "Dëshmorët e Kombit", Tiranë
E-mail: zvdekan.fas@uart.edu.al; elismataj@gmail.com

Z. Jonid Jorgji

Kryetar i Qendrës Kombëtare të
Kinematografisë

Data: 14 / 01 / 2026

Prof. Dr. Erald Bakalli

Rektor i Universitetit të Arteve

Data: 14 / 01 / 2026



Vulosur dhe nënshkruar në Tiranë, më datë 14 / 01 / 2026.